

NJOFTIM PËR TENDER



**Raiffeisen
Bank**

EMRI I TENDERIT: **BLERJE DHE MIRËMBAJTJE E SISTEMIT TË KLIMATIZIMIT**

Referenca e tenderit: T008-03/26

Data e hapjes: 03 Mars 2026

Data e mbylljes: **16 Mars 2026 @ 15:00**

Lloji i Kontratës: Marrëveshje për Blerje dhe Shërbime

Autoriteti Kontraktues: Raiffeisen Bank Kosovo J.S.C.

Mars 2026

Përmbajtja

1	INFORMATA TË PËRGJITHSHME.....	3
1.1	Qëllimi i këtij dokumenti	3
1.2	Informata për autoritetin kontraktues.....	3
1.3	Afatet dhe Kushtet për Raiffeisen Bank Kosovo J.S.C.	3
1.4	Procesi për shprehje të interesit	4
1.5	Fushëveprimi	4
1.6	Oraret	4
1.7	Pranimi i punës dhe përgjegjësia	5
1.8	Nënkontraktorët.....	5
1.9	Të ndryshme.....	5
2	KËRKESAT PËR OFERTAT FINANCIARE:.....	7
2.1	Kushtet e përgjithshme:	7
2.2	Kushtet dhe rregullat e tenderit:.....	8
2.3	Komunikimi	8
2.4	Ecuria e tenderit.....	8

1 INFORMATAT TË PËRGJITHSHME

1.1 Qëllimi i këtij dokumenti

Ky dokument ka për qëllim që të ofroj te gjitha informatat e nevojshme pjesëmarrësve në këtë tender se si të dorëzojnë ofertën e tyre për Blerje dhe mirembajtje e sistemit te klimatizimit T008-03/26.

1.2 Informata për autoritetin kontraktues

Banka Raiffeisen në Kosovë është degë e Raiffeisen Bank International AG (RBI). RBI erdhi në Kosovë në fund të vitit 2002 duke blerë pjesën më të madhe të aksioneve të Bankës Amerikane të Kosovës. Në qershor të vitit 2003, Banka u riemërtua si Banka Raiffeisen në Kosovë. RBI ofron shërbime dhe produkte bankare dhe investuese për kompanitë austriake dhe ndërkombëtare, një rrjet të gjerë të njësive bankare dhe lizing në Europën Qëndrore dhe Lindore për korporata dhe retail. Përveç kësaj, Grupi përbëhet nga shumë kompani të shërbimeve financiare, për shembull në fushën e leasing, menaxhimit të aseteve si dhe në fushën e blerjeve dhe shkrirjeve.

Sipas bilancit të gjendjes të datës 31 dhjetor 2025, asetet e përgjithshme të Bankës Raiffeisen në Kosovë ishin 1.921 milionë Euro, depozitat e klientëve 1.551 milionë Euro, ndërsa portofoli i kredive ishte 612 milionë Euro. Banka Raiffeisen ka një kapital prej 63 milionë Euro.

Banka Raiffeisen ofron një gamë të gjerë të shërbimeve dhe produkte bankare për të gjithë klientët: individët, ndërmarrjet e vogla dhe të mesme dhe të korporatave. Që nga fillimi i punës së saj në Kosovë, Raiffeisen Bank është shumë e suksesshme duke përkrahur zhvillimin e të gjitha segmenteve me produkte të ndryshme, duke përfshirë kreditë dhe depozitat.

Për të përkrahur aktivitetet tona të biznesit dhe për të ofruar shërbime të kualitetit të lartë për klientët tanë përmes teknologjisë më të re, ne kemi vazhduar të investojmë në Teknologji informative dhe operacione. Si vlerësim për këtë, banka jonë arriti të bëhet kompania e parë në rajon e certifikuar për ISO 20000 dhe 14001 nga Registered Quality Assurance (LRQA)

Për më shumë informata rreth Raiffeisen Bank Kosovo J.S.C., ju lutemi vizitoni:

<http://www.raiffeisen-kosovo.com>

1.3 Afatet dhe Kushtet për Raiffeisen Bank Kosovo J.S.C.

Ju duhet ta keni parasysh se me rastin e aplikimit në këtë tender dhe dorëzimit të ofertës financiare, keni lexuar dhe kuptuar paraprakisht dhe pajtoheni me Kushtet dhe Termet e Bankës Raiffeisen Kosove që mund t'i gjeni në linkun në vazhdim:

[Termet dhe kushtet e përgjithshme për prokurimin e mallrave dhe shërbimeve në Bankën Raiffeisen Kosovo J.S.C](#)

1.4 Procesi për shprehje të interesit

Banka Raiffeisen në Kosovë fton të gjitha kompanitë e interesuara të ofertojnë për tenderin Blerje dhe mirembajtje e sistemit të klimatizimit T008-03/26.

Palët e interesuara duhet të dergojnë kërkesën për pjesëmarrje në prokurimi@raiffeisen-kosovo.com

Në kërkesë të përfshihen dokumentet si në vijim:

- Certifikata e regjistrimit të biznesit.
- Dokumenti identifikues i pronarit të ndërmarrjes.
- Detajet tjera kontaktuese (adresa, numri kontaktues dhe email-i zyrtar).
- Të gjitha dokumentet më lartë duhet të jenë të vulosura dhe nënshkruara.

Afati i fundit për dorëzimin e këtyre dokumenteve fillestare dhe të nevojshme për regjistrim në platformën elektronike të Prokurimit (eSourcing) është **10 Mars 2026, ora 15:00**.

Dokumentet e pranuar pas këtij afati nuk do të konsiderohen dhe rrjedhimisht mund të mos ftoheni për kuotim.

Aplikimi bëhet vetëm përmes platformës eSourcing. Kompanitë duhet të plotësojnë kushtet e parastruara për të u kualifikuar në procesin e përzgjedhjes së ofertave.

1.5 Fushëveprimi

Qëllimi kryesor i këtij procesi është rekrutimi i një operatori profesional dhe i aftë të kompletojë shërbimet e kërkuara të furnizimit, instalimit dhe mirëmbajtjes së njësive aktuale ftohëse në objektet e bankës Raiffesien. Operatori i sukseshëm duhet të jete i specializuar për shërbime në mirëmbajtje, servise të njësive të klimatizimit dhe instalimit të njësive ftohëse.

Shërbimet e specializuara të kësaj natyre janë:

- Mirëmbajtja dhe servisi i pajisjeve ekzistuese
- Furnizime me pajisje të reja sa herë kërkohet,
- Disponim i pjesëve rezervë dhe materialeve tjera dhe thirrje sipas nevojës për intervenime në sanim të problemeve.

Gjatë implementimit të kontratës secila detyrë duhet të diskutohet paraprakisht me stafin e RBKO-së për të kuptuar natyrën e detyrës dhe rezultatin e pritur që kërkohet.

Komunikimi duhet të rrjedhë përmes postës zyrtare/e-mailit.

Operatori i sukseshëm duhet të veprojë në përputhje me kërkesat e paraqitura nga stafi përgjegjës i Bankës.

1.6 Oraret

Çdo detyrë dhe kohëzgjatja e saj (nëse kërkohet) duhet të aprovohet në bashkëveprim me personelin e Bankës.

Nëse kërkohet, operatori harton dhe mirëmban një plan dinamik të detajuar që tregon implementimin e detyrave.

Operatori kërkohet që në raste të caktuara të punojë edhe gjatë vikendeve, festave zyrtare (në raste extreme) si dhe deri në orët e vona të natës.

Operatori duhet të organizohet që një spektër i punëve të organizohen dhe kompletohen pas orarit të punës ose edhe në orët e hershme të mëngjesit.

Gjatë ekzekutimit të punëve nga fusha e vet e përgjegjësisë, operatori sigurohet që nuk shkakton pengesa direkte ose anësore për personelin e RBKO-së. Kontraktoi duhet të jete fleksibil, me shkallë të lartë të organizimit dhe mobilitetit.

Operatori i sukseshëm pritët që ta ta respektoj me saktësi orarin e kryerjes së shërbimeve në mënyrë që mos ta afektojë mbarëvajtjen e punimeve ose funksioneve të tjera në bankë.

Organizimi i punës ndonjëherë kërkon që ekipet punuese të operatorit të punojnë në bashkëveprim edhe me operatorët e tjerë në kuadër të projektit apo detyrës së dhënë.

Projekti udhëhiqet nga një personel përgjegjës i RBKO-së i cili udhëzon, këshillon, inspekton, kërkon dhe autorizon veprime, syzjerime dhe masa më qëllim të kompletimit të sukseshëm të detyrave

1.7 Pranimi i punës dhe përgjegjësia

Puna certifikohet/pranohet nga staffi përgjegjës i Bankës.

Operatori i sukseshëm është përgjegjës që të gjitha kërkesat dhe udhëzimet për punë dhe projekte ti merr dhe të njëjtat i zbaton konform dakordimeve paraprake me personelin përgjegjës nga departamenti i PGSP-së.

Operatori i sukseshëm mund të pranojë kërkesa për vizita në objekte të ndryshme të bankës Raiffeisen me qëllim të pregaditjes së ofertave, gjetjeve të zgjidhjeve teknike gjatë instalimeve, si dhe parapregaditje për punime.

Operatori i sukseshëm duhet të ofrojë (atëherë kur kërkohet) pregaditje të skicave apo të ofrojë skicat pas instalimit të pajisjeve të ndryshme në formatin dëg ose PDF.

Operatori i sukseshëm – duke mos u kufizuar në kategoritë që përmenden këtu-ka për obligim që në çdo servisim, intervenim, furnizim, instalim të plotësojë urdhërin e punës me të gjitha shënimet e nevojshme si: Lokacioni, Objekti, përshkrimi i shërbimit, materialet e përdorura. Fleta e punës ta ketë nënshkrimin nga personeli përgjegjës i objektit (pikës ku ofrohet shërbimi) duke qartësuar edhe emrin dhe mbiemrin e personit nënshkrues. Fatuara për çdo shërbim shoqërohet me fletën e punës. Format i raportit do të dakordohet me personelin përgjegjës të bankës Raiffeisen.

Operatori i sukseshëm ka për obligim që për çdo sistem të klimatizimit si chillerë (ftohës qëndrorë), klime ekzistuese apo furnizim i ri, të ofrojë sqarime (nëse ka nevojë) dhe trajnim të personelit për operim me pajisje. Për furnizime të reja obligohet edhe dorëzimi i manualeve të përdorimit dhe udhëzimeve të mirëmbajtjes.

Operatori i sukseshëm në çdo ofrim të shërbimit ka për detyrë që të lajmërohet tek përgjegjësi i pikës ku ofrohet shërbimi dhe të kërkojë leje për operim, intervenim dhe në disa raste edhe të pres derisa të krijohen kushtet për mospengim të operimit të bankës.

1.8 Nënkontraktorët

Operatori mundet që të bëjë nënkontraktimin e disa shërbimeve. Nënkontraktimi nuk krijon marrëdhënie kontraktuale në mes të bankës Raiffeisen dhe palës nënkontraktuese. Ju lusim që të bashkëngjiti listën e nënkontraktorëve (nëse planifikojnë të angazhoni).

Operatori i sukseshëm është përgjegjës për të gjitha veprimet, gabimet dhe shërbimet e ofruara nga ana e nënkontraktorëve ose palevë të treat që veprojnë nën emrin e tij.

Lista e nënkontraktorëve (nëse planifikojnë të kenë) dhe dëshmia që shërbimet e tyre i nënshtrohen autoritetit kontraktues

1.9 Të ndryshme

Operatori kërkohet që të plotësojë kërkesat administrative të RBKO-së si: oferta, vlerësime, kalkulime, raporte, 'as built' dokumente në formatin dwg - në raste të caktuara si dhe fatura, me qëllim të kompletimit të obligimeve kontraktuale.

Operatori i sukseshëm duhet të ofrojë dërgim të paramasës apo parallogarisë për punët/projektet që kërkohen.

Operatori i sukseshëm duhet të ofrojë dokumentacionin teknik sa herë kërkohet si: specifikacione teknike, certifikata të kualitetit për produktet e kërkuara.

Me qëllim të komunikimit të shpejtë dhe efikas preferohet që komunikimi të jetë me e-mail.

Operatorit të sukseshëm i kërkohet që në raste të caktuara të kompletojë ad-hoc detyra me qëllim të kompletimit të projektit.

Operatori është përgjegjës për krejt masat e zbatueshme të sigurisë në punë që kërkohen nga organet lokale dhe qendrore të rregulluara me ligjet dhe aktet tjera ligjore në fuqi.

Nëse identifikohet ndonjë problem i klimave gjate servisimit, koha e raportimit tek personeli përgjegjës i bankës duhet te jete sa me e shkurtër/brenda dite. Te gjitha raportimet behën me shkrim, përmes e-mailit zyrtar.

2 KËRKESAT PËR OFERTAT FINANCIARE:

- Ju lutemi që ofertën tuaj ta dorëzoni brenda afatit të dhënë. **Ofertat pranohen vetëm në formën elektronike dhe sipas manualit të bashkangjitur.**
- Oferta duhet të dorëzohet për të gjitha linjat brenda Shtojcës 1 ato gjysmake do të përjashtohen nga procesi i vlerësimit.
- Oferta duhet të dorëzohet në valutën Euro dhe duhet të përfshijë TVSH, kostot e transportit ,instalimit dhe funksionalizimit si dhe të gjitha taksat tjera.

2.1 Kushtet e përgjithshme:

- Të përfshijë detajet e llogarisë bankare të ofertuesit.
- Të përmbajë numrin e ofertës .
- Të përmbajë datën e ofertës.
- Vlefshmëria e ofertës duhet të jetë së paku 90 ditë nga dita e dorëzimit.
- Çdo faqe e ofertës duhet të vuloset dhe të nënshkruhet nga personi i autorizuar i kompanisë.
- Ofertës duhet t'i bashkangjitet organogrami organizativ i ndërmarrjes.
- Dëshminë se kompania nuk ka borxhe ndaj autoriteteve vendore.
- Ofertës gjithashtu duhet t'i bashkangjiten së paku tri referenca të lëshuara nga institucione me reputacion të lartë, që konfirmojnë se ofertuesit kanë ofruar shërbime të ngjashme apo kanë kryer në mënyrë të kënaqshme punë të ngjashme me ato të kërkuara me këtë dokument (jo më të vjetra se tri vite).
- Ofertës ti bashkangjiten diplomat e stafit profesional (inxh. i dipl. i makinerise, drejtim ngrohje dhe klimatizim)
- Ofertës duhet t'i bashkangjiten edhe certifikatat (kualitetit, eficiences EER)
- Ofertës ti bashkangjitet autorizim nga prodhuesi për shitjen dhe mirembajtjen e produktit që ofron.
- Operatori mund të bashkangjes informata shtesë që janë relevante për klima të reja (p.sh. katallogun)
- Nëse posedoni, të bashkëngjiten certifikatat që dëshmojnë pajtueshmëri me:
 - Standardet mjedisore dhe/ose
 - Konceptit për zhvillimit të qëndrueshëm.
- Dokumentet e mësipërme ngarkohen / bashkëngjiten direkt në platformë në formatin PDF.

2.2 Kushtet dhe rregullat e tenderit:

- Ne ruajmë të drejtat për të ndryshuar specifikat, për të anuluar këtë tender, për të ftuar sërish pjesëmarrës të caktuar që ta dorëzojnë prapë ofertën e tyre, dhe për të diskualifikuar cilindo ofertues pa dhënë njoftime paraprake apo arsye për këtë
- Banka rezervon të drejtën e ndryshimit të porosive lidhur me sasi të
- Ne ruajmë të drejtat për të mos kontaktuar me ofertuesit gjatë procesit të tenderimit
- Ofertat që nuk u përmbahen kushteve të parashtruara në këtë dokument mund të diskualifikohen nga procesi i përzgjedhjes.
- Përzgjedhja e fituesit bazohet në vlerësimin e Komisionit të Tenderit dhe vendimin e Bordit Menaxhues.

2.3 Komunikimi

Komunikimet për këtë tender duhet të bëhen në të shkruar dhe preferohet përmes emailit. Drejtoni pyetjet tuaja tek departamenti i Prokurimit sipas detajeve në vijim:

Departamenti i Prokurimit
Rr. "Robert Doll" nr. 99, Prishtinë 10 000, Kosovë
email: prokurimi@raiffeisen-kosovo.com

2.4 Ecuria e tenderit

Aktivitet	Data
Publikimi i tenderit	03 Mars 2026
Afati i fundit për shprehje interesit	10 Mars 2026 @ 15:00
Hapja e platformës online për kuotim	11 Mars 2026
Afati i fundit për dorëzim të ofertës	16 Mars 2026 @ 15:00
Njoftimet për ofertuesit:	Pas marrjes së vendimit